

PËR NJË KËMBIM INTENSIV TË LETËRKËMBIMIT TË MJEDËS ME ALBANOLOGËT E HUAJ

MENTOR QUKU

Lagja Perlat Rexhepi, Rruga Asim Vokshi, Shkodër

Email: mentorquku@yahoo.com

1. Hyrje

Problemet e metodës, sot përbëjnë, thelbin e preokupacioneve në fushë të studimeve albanologjike. Prandaj edhe tendencat për kërkime në fushë të metodologjisë, për të sjellë realitete të reja në studimet albanologjike janë krejtësisht të legjitimuara. Duhet pranuar se këto studime kanë vuajtur nga prirje frenuese-shtrembëruese, si: Ndërhyrje e pastër e politikës, një lloj vetmbylljeje brenda një qarku të caktuar e të kontrolluar të burimeve, një lloj vetseleksionimi tendencioz të kërkimeve, prirje drejt temave “*të mëdha*” me karakter të përgjithshëm, prirje për të paravendosur përfundimet “*shkencore*”, prirje për punë “*shkencore*” me porosi, prirje për pseudoshkencë të çensuruar, për retushimin e dokumenteve, apo për neglizhimin e tyre me qëllime të paracaktuara. Edhe sot vazhdohet me një neglizhencë të pajustificueshme në planifikimin e organizimin e kërkimeve shkencore për të zbuluar, përpunuar dhe analizuar dokumentet dhe burimet e historisë, gjuhës, letërsisë, folklorit, etnologjisë, arkeologjisë, e të shkencave të varura prej tyre.

2. Historia si përplasje metodash

Sot bëhen përpjekje për të kërkuar metoda të reja e efikase të studimeve albanologjike, për të hequr dorë nga metoda të dështuara apo tema tabu, për të hequr dorë nga sloganet në fushë të kërkimit shkencor. Për shkak të ruajtjes së gjendjes, vërehet një përplasje në mes të tendencave metodike të reja dhe bartësve të praktikave të vjetra. Sulmohen studiuesit që prirën drejt gjurmimit të burimeve, si empirikë. Në të vërtetë empiriokritikët e sotëm janë dogmatikët e idhtarët e djeshëm të rrymave anti deri në joshkencore, pseudoracionalistët, pseudoshkencëtarët, individë pa produkte shkencore, të aftë për të ngritur shkallët e karrierës e për t’u zbuluar me pseudotituj.

Është vendi të sjellim shembullin e kërkimtarëve të mëdhenj në fushë të arkivave, të folmes së gjallë të popullit, të gjetjeve arkeologjike, të bibliomanëve, si

Coleti, Farlati, Valentini, Mjeda, Çabej, Roques, Gazulli, Jokli, Bernardin Palaj, Jup Kastrati, etj. të gjithë shkencëtarë të mëdhenj, shembuj për t’u ndjekur.

Po flitet shumë për historinë e Letërsisë Shqipe, si një grindje për metodikën. Çfarë është historia që pretendojmë të kemi? Nëse historia duhet shkruar, rishkruar, apo përmirësuar. Pak ose shumë historia e jonë ka qenë e mbarsur me politikën, është përdorur nga ajo, është rimorkjuar nga ajo. Sot ka trend për të vazhduar me atë klasë historianësh, të cilët në kushte të reja, më tepër punojnë për të justifikuar veten se sa për t’iu përveshur më në fund gjurmimeve, kërkimit të burimeve, përpunimit të tyre në nivele shkencore, dhe mbi to, për të shkruar historinë. Ajo mund të jetë subjektive, objektive, varet nga sa mundësi kanë studiuesit për t’i përpunuar e analizuar për të nxjerrë përfundime, historianët shkencëtarët e letërsisë. Por ama metoda duhet të jetë vetë ajo e ndërtuar mbi baza e kritere shkencore. Ndryshe historianët kthehen në letrarët e sotëm, të cilët përpiqen të bëjnë letërsi. Shkenca synon të zbulojë të vërtetat historike dhe kjo realizohet nëse përqafojmë metodën e duhur. Në lidhje me metodën shkencore nuk besoj se mund të bëhen kompromise me politikën. Në të gjitha rastet kur ndodh kjo, produkti shkencor fillon të çalojë, mbeten rrugës dhe nuk mund të përballojë rrebeshin e kohës. Debati për metodën është problemi që duhet të përballohet sot. Mbetet të përcaktohet qartë në se metoda e punës është në shërbim ose jo të interesave jashtëshkencore. Këtu nuk mund të bëhen kompromise. Edhe sot dominojnë përpjekjet për të mbarsur sadopak shkencën me politikën, ose për të justifikuar botimet pseudoshkencore të tyre. Por nga ana tjetër, nuk mund të përjashtohet asnjëri nga skena e kërkimeve shkencore. Në kushtet e sotme, çdo devijim është një vetpërrjashtim, që vjen nga sistemi demokratik, Brenda të cilit gjallon shkenca shqiptare. Sot nuk është fjala për t’i dhënë medaljen apo për ta gjykuar dikë, por bëhet fjalë që të bëjnë historinë ata

që respektojnë kriteret shkencore në metodë të punës, pavarësisht nëse janë të vjetër apo të rinj, me të kaluar të pastër apo jo. Secili historian të pyesë veten nëse kërkon t'i shërbejë politikës, në se kërkon të justifikojë veprat e veta, nëse kërkon të fitojë edhe sot diçka nga politika e ditës? Në të gjitha këto raste asnjë të mos habitet pse historitë e tyre nuk i rezistojnë kohës. Fatin e veprave të veta e ka në dorë secili. Vazhdimisht janë shkruar histori nga sherbëtorë, nga zëdhënës, nga udhëtarë e diplomatë të huaj, të cilët pasi kanë marrë porosinë, kanë bërë disa shetitje turistike nëpër vendin tonë, ose kanë gjurmuar disa ditë në arkiva tona, kanë shkruar *Historitë tona*.

Mendojmë se çdo studiues duhet të kalojë në tre faza: Periudha e parë është ajo e gjurmimit të dokumenteve e burimeve të tjera. Dokumentet e historisë shqiptare janë në arkiva, biblioteka e muzeume Brenda e jashtë vendit. Periudha e dytë është ajo e hartimit të monografive, kumtesave, studimeve të pjesshme mbështetur mbi të dhënat e gjurmimeve të bëra. Kurse faza e tretë është ajo e hartimit të historisë, e cila përbën një arritje, mbështetur mbi rezultatet e dy fazave të para të studimit. Fazat nuk janë të prera me thikë, por mund të bashkërenditen në sinkron njera me tjetrën. Kjo përbën thelbin e metodës kërkuese-krijuese-përgjithësuese.

3. Metoda e ime shkencore mbi Mjedën

Me qëllim që të ilustroj ato që thashë mbi historinë si grindje metodike, po sjell thelbin e metodës sime shkencore, të cilën e kam vënë në themel të projektit tim rreth jetës dhe veprës së Ndre Mjedës. Fillova të kërkoj në arkivat, muzeumet dhe bibliotekat e Shqipërisë. I kërkova mal më mal, qytet më qytet të gjithë bashkëkohësit, nxënësit, intelektualët, bashkëpunëtorët e Ndre Mjedës. Krijova arkivin tim, të cilin kam 37 vjet që e pasuroj çdo ditë. Tek-tuk publikoja ndonjë gjë të vogël. Ndërkohë filluan reagimet e para: Grupi i parë ishin *pseudot* që nuk deshën të më praninin në fushën eshkencës, megjithëse ato gjithë kohën spekullonin. Një pseudogjuhëtar më këshilloi që *të mos hyja në fushat e tij!* Një pseudohistorian, më njoftoi me keqdashje se sapo ishin botuar dy monografi mbi Mjedën. Një pseudoprofesor i Historisë vuri në dukje se puna ime ishte empirike. Zoti i faltë se nuk dinin çfarë bënin. Por pata edhe shumë mbështetës e shumë dashamirës: studiuesin Ahmet Osja, i cili nuk la vend pa mbrojtur e vlerësuar punën time, gazetari i gaz. *Bashkimi*, Besnik Dizdari, redaktori i revistës *Ylli* Shefki Karadaku, sekretari i kolegjiut të *Nëntorit* Zef Gurakuqi, të cilët botuan disa nga studimet e mija mbi Mjedën. Vazhdova 30 vjet, duke kërkuar në arkiva, biblioteka, universitete, muzeume, programe internetesh dhe

vetëm në vitin 2004 i hyra punës për hartimin e botimit e tetë monografive kushtuar jetës dhe veprës së tij. Sot mund të ndjehem i plotësuar që arrita të botoj shtatë prej këtyre monografive, secila prej të cilave është një esse më vete, kushtuar një periudhe të caktuar të jetës së Mjedës. Tani e shoh veten pranë realizimit të projektit, duke synuar finalen, hartimin e *Historisë së Mjedës*.

4. Letërkëmbimi i Mjedës

Për letërkëmbimin e Mjedës me albanologët e huaj, duhet kërkuar në mënyrë të organizuar, kryesisht me G. Meyer (1850-1900), H. Pedersen (1867-1953), W. Thomsen (1842-1927), R.Thurneysen (1857-1940), M. Bloomfield (1855-1928), K. Brugmann (1849-1919), L. Schroeder (1851-1920), L. Reinisch (1832-1919), D.H. Muller (1846-1912), A. Meillet (1866-1936), G. Waigand (1860-1930), P.Kretschmer (1866-1956), J.U.Jarnik (1848-1923), R.Nahtigal (1877-1942), N.Jokli (1877-1942), V.Jagic (1838-1923), F. Nopsca (1877-1933), K. Krumbacher (1856-1909), J. Karabacek (1885-1918), M. Lambertz (1882-1963), P. Skok (1881-1956), F. Cordignano (1887-1953), Z.Valentini (1900-1980), C. Tagliavini (1903-1982) e shumë të tjerë. Mjeda ka ndihmuar dhe nxitur interesimin e shumë shkencëtarëve të njohur të huaj drejt studimeve shqiptare. Ai u fali atyre punën e vet duke ndikuar në orientimin e tyre drejt studimeve albanologjike, por edhe bëri analiza të guximshme, argumentime dhe ndërhyrje kritike. Ai mori pjesë me dinjitet dhe integritet të plotë në diskutimin e çështjeve të rëndësishme të studimeve shqiptare, shpesh herë duke kritikuar me takt, por me guxim pikëpamjet dhe konkluzionet e gabuara të albanologëve të huaj. Ai gëzoi interesimin dhe respektin e studiuesve të huaj, të cilët vlerësuan tek ai, formatin prej shkencëtari, duke ngjallur habinë për arritjet e pjekurisë profesionale të tij.

Ne, sot, njohim vetëm një pjesë të vogël të letërkëmbimit e të bashkëpunimit që pati Mjeda me albanologët e huaj, si dhe të kontributeve të tij të shquara në studimet albanologjike. Përvoja e zbulimeve të deritanishme në këto drejtime na ka mësuar se brenda këtij bashkëpunimi qëndrojnë të papritura dhe zbulime të tjera të karakterit albanologjik.

Mbetet që të organizohen kërkime intensive për zbulimin e letërkëmbimit të Ndre Mjedës me albanologët e huaj. Ata që duan të hyjnë në këtë fushë të kërkimit shkencor, duhet që, përveç problemeve me karakter të përgjithshëm të kërkimit shkencor, të zotërojnë edhe veçoritë e këtij letërkëmbimi. Megjithëse është lokalizuar në një masë të mirë gjeografia e këtij letërkëmbimi, mbetet që në të

ardhmen të bëhen kërkime të tjera. Gjatë zbulimit të letrave të këmbryera të Mjedës me albanologët e kohës mund të dalin informacione me vlerë për lidhje të panjohura të tij në këtë drejtim. Duhet lokalizuar vendet, adresat se ku janë sistemuar fondet e albanologëve të ndryshëm, me të cilët dyshohet se Mjeda ka patur letërkëmbim, që mund të jenë, biblioteka nacionale, të universiteteve, apo të instituteve pedagogjike, shkencore, në muzeume, arkiva, etj. Brenda këtyre fondeve, kryesisht personale, mund të lokalizohen dosjet e letërkëmbimit të tyre, ose mund të bëhen kërkime në dosjet e dorëshkrimeve, brenda këtyre fondeve. Letërkëmbimi i supozuar duhet të jetë shoqëruar me shkëmbime veprash apo dorëshkrimesh nga ana e albanologu ynë, prandaj nuk duhet neglizhuar kërkimi i tyre. Shkëmbime të kësaj natyre, kanë qenë në praktikën e rutinën e kohës. Në rastin e Ndre Mjedës vërejmë prirjen e tij për të nxitur albanologët e huaj për t'u marrë me studime albanologjike, për çka ai u ka falur atyre leksema, paradigma, tekste me legjenda, këngë, fjalë të urta, etj. Duhet kërkuar letrat së bashku me zarfat, me kartpostalet sepse ato mund të kenë të dhëna plotësuese lidhur me dërgimin e hartimin e letrave, datimin e tyre si edhe informacione të tjera me rëndësi. Duhet bërë supozime lidhur me letra ose dokumente të mundshme, mbi të dhënat që na vijnë nga letrat e zbuluara, duke mos neglizhuar asgjë. Një fushë tjetër me interes është kërkimi i kopjeve të letrave të vetë albanologëve, të cilat ato kanë patur zakon t'i bëjnë e t'i ruajnë në arkivat e tyre private. Kujtojmë këtu eksperiencën pozitive të kopjeve të pesë letrave të Gustav Meyerit, që i kishte dërguar Mjedës, zbuluar nga Rinush Idrizi. Paraqet rëndësi leximi, transkriptimi fonetik, apo transliterimi i letrave, dorëshkrimeve apo dokumenteve të tjera. Pastaj vjen datimi e analizimi i tyre me qëllim që të bëhen pronë e

studiuesve apo lexuesve shqiptarë. Duhet bërë kërkime sidomos në arkivave Vatikanit, si edhe në arkivin e provincës venete, në Gallarate (Itali), në arkivat shqiptare, në ato të Vjenës, Stambollit, etj. Duhet bërë kërkime edhe në arkivat personale të ish nxënësve apo dishepujve të Mjedës. Po japim disa letra që kemi në dorë nga letërkëmbimi i Mjedës me albanologët, përjashto këtu ato për të cilat kemi bërë publikimin dhe analizën e tyre në monografitë e mëparshme të kësaj serie.

5. Përfundime

Në çfarë drejtimesh duhen organizuar kërkimet për letërkëmbimin e Mjedës me albanologët e huaj? Përveç institucioneve shkencore, duhen nxitur e aktivizuar edhe kërkuesit me programe individuale apo OIQ. Po kështu duhen bërë kërkime nga institutet pedagogjike. Duhet nxitur e aktivizuar rrethet diplomatike të cilat kanë për detyrë hulumtimin e prezencës së kulturës sonë në shtetet respektive, atje ku përfaqësohen interesat tona kombtare. Në çfarë rrugë tjetër mund të kryejnë detyrat e tyre zyrtar diplomatike tonat në botë, për të mbrojtur interesat tona, për të nxitur frymën e bashkëpunimit me vendet ku janë akredituar, përveç gjurmimit të dokumenteve e burimeve të tjera të vlerave tona kombëtare nëpër fondet që ruhen në arkivat bibliotekat e muzeumet jashtë vendit. Gjithashtu duhen nxitur rrethet tona shkencore apo pasuniversitare, prezente në shtete ku gjenden pjesë të këtij letërkëmbimi, sidomos ato të shkencave shoqërore. Së fundmi, krijimi i një fondacioni Mjeda do të luante një rol pozitiv në rastin tonë konkret. Ai mund të jepte çmime inkurajuese për studime mjedologjike, të shpërndante bursa për studiues të rinj për të nxitur kërkimet në arkiva, biblioteka e muzeume, si edhe të ndihmonte në botimin e studimeve të bëra rreth jetës dhe veprës së Mjedës.